



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT
TË ARSIMIT TË LARTË**

Nr. ____ Prot., Datë ____ . ____ .202__



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI _____

Nr. ____ Prot., Datë ____ . ____ .202__

**KONTRATA
E GARANCISË DHE LLOGARIDHËNIES**

E lidhur sot, në Tiranë, më datë ____ . ____ .202__, midis dy palëve, si më poshtë:

- Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë, në cilësinë e organit shtetëror përgjegjës në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit që ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve publike, i përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm Z/Znj. _____, i cilësuar më poshtë, për efekt të kësaj marrëveshje, si “AKFAL”,
- Institucionit publik të arsimit të lartë: _____, person juridik publik, në cilësinë e institucionit të arsimit të lartë, i përfaqësuar nga _____ i institucionit të arsimit të lartë Z/Znj. _____, i cilësuar më poshtë, për efekt të kësaj marrëveshje, si “IAL”,

Bazuar në ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në gërmën “e”, të pikës 3, të vendimit nr. 397, datë 3.5.2017 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL)”, të Këshillit të Ministrave, Vendimit nr. 75, datë 12.2.2018, “Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor”, i ndryshuar, Udhëzimit të përbashkët të MAS dhe MFE, nr. 20, datë 20.9.2019 “Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor”, i ndryshuar, të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.08.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me vullnet të lirë, palët e kësaj marrëveshje bien dakord për sa më poshtë:

**Neni 1
Objekti i marrëveshjes**

1. Objekti i kësaj marrëveshje është përcaktimi i:
 - a) vlerës së financimit nga Granti i Mësimdhënies i miratuar nga AKFAL për Universitetin _____, për vitin buxhetor _____.
 - b) garancive që universiteti jep për realizimin e objektivave strategjike për arsimin e lartë, sigurimin e integritetit akademik dhe transparencës.
 - c) mënyrës së përdorimit të fondeve nga buxheti i shtetit dhe formës së raportimit dhe llogaridhënies.

Neni 2

Kushtet Specifike

1. Fondet e përfituara nga IAL-ja administrohen në përputhje me qëllimin e miratuar dhe me aktet nënligjore, si dhe me kushtet specifike të përcaktuara, si më poshtë:
 - a) IAL angazhohet dhe garanton realizimin dhe plotësimin e kushteve të nevojshme me qëllim arritjen e objektivit të përbashkët për rritjen e cilësisë dhe performancës, në mësimdhënien akademike, në ofrimin e arsimit të lartë dhe programeve të studimit si dhe në kërkim shkencor.
 - b) IAL sipas akteve ligjore në fuqi dhe fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti i shtetit, mbështet me bursë studentët në nevojë, të shkëlqyer dhe ato që ndjekin studimet në programe prioritare, për t'iu dhënë mundësinë dhe aksesin e barabartë në ndjekjen e arsimit të lartë.

Neni 3

Masa e financimit

1. Kjo marrëveshje është e vlefshme për masën e financimit të përfituar për vitin buxhetor _____.
2. Universitetit _____ i alokohen në formë Granti Mësimdhënie, në total _____ lekë, i cili përbëhet nga:
 - a) Fondi për mbështetjen studentore në masën _____ lekë, për financimin me bursa studimi për studentët që plotësojnë një nga kriteret e përcaktuara në VKM nr.903/2016, e ndryshuar.
 - b) Fondi për mbështetjen studentore _____ lekë, për financimin me bursa studimi në masën e pagës minimale për studentët që plotësojnë një nga kriteret e përcaktuara në VKM nr.386/2022, e ndryshuar.
 - c) Fondi për mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë (Fondi Institucional) _____ lekë.
3. Universitetit _____ i shpërndahen _____ lekë, fonde grant nga buxheti i shtetit për rimbursimin e vlerës së tarifave vjetore të reduktuara për studentët sipas VKM nr.288/2018 e ndryshuar dhe VKM nr.780/2018, e ndryshuar, si dhe për rimbursimin e tarifave vjetore për studentët të cilët përjashtohen nga pagimi i saj sipas VKM nr.269/2017, i ndryshuar.
4. Objekt i kësaj marrëveshje është dhe çdo fond i alokuar përgjatë vitit buxhetor _____, dhe fondet e trashëguara nga viti paraardhës, që i përkasin *Grupit 11, Programi 09450, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605, 606.*

Neni 4

Edukimin akademik

1. Universiteti _____, do të ofrojë edukim akademik në (shënohet numri i njësive kryesore). Njësi Kryesore, nga të cilat (shënohet numri i fakulteteve) Fakultete, (shënohet numri i instituteve) Institute Kërkimore-Shkencore, si dhe në degën e IAL-së në (shënohet vendi brenda Republikës së Shqipërisë ku ushtron aktivitetin).
2. Institucioni ofron edukim akademik në (shënohet numri i programeve) programe të ciklit të parë të studimeve bachelor, (shënohet numri i programeve) në programet e integruara dhe (shënohet numri i programeve) programet profesionale, të organizuara, si më poshtë:
 - a) Fakulteti (shënohet emri i fakultetit), ofron edukim akademik në (shënohet numri i programeve) në programet e studimit në, (shënohet fusha e programit të studimit sipas shtojcës nr.1 të VKM nr.75/2018), me koeficientë financimi bazuar në kosto mesatare (koeficienti sipas shtojcës nr.1 të VKM nr.75/2018), prej të cilave:
 - i. (shënohet numri i programeve) programe prioritare,
 - ii. (shënohet numri i programeve) programe studimi të përbashkëta, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me IAL-të e shteteve të tjera, në kuadër të procesit të ndërkombëtarizimit të studimeve.
 - iii. (shënohet numri i programeve) programe studimi me karakter profesional.

Neni 5

Struktura e brendshme financiare

1. Institucioni garanton funksionimin dhe realizimin e detyrave të strukturave të brendshme për menaxhimin financiar, duke përfshirë Bordin e Administrimit, Administratorin, Administratorët e njësive bazë, si dhe personelin përgjegjës administrativ sipas strukturës organizative të miratuar.
2. Bordi i Administrimit është organi përgjegjës i cili garanton qëndrueshmërinë financiare të institucionit të arsimit të lartë, përmbushjen e misionit dhe objektivave të tij.
3. Administratori është autoriteti përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit, i cili ndjek dhe kontrollon zbatimin e buxhetit vjetor të institucionit të arsimit të lartë në strukturat e varësisë së tij.
4. Strukturat financiare të IAL-së garantojnë përdorimin e fondeve dhe plotësimin e kushteve specifike sipas parashikimeve në këtë marrëveshje dhe raportojnë pranë AKFAL.

Neni 6

Skema e monitorimit

1. Monitorimi mbi përdorimin e Grantit të Mësimdhënies realizohet nga Agjencia Kombëtare e Financimit të Arsimit të Lartë në cilësinë e financuesit.

- 
2. Kontrolli i brendshëm financiar në institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë përbërëse të tyre realizohet nga njësitë e auditimit të brendshëm të institucionit, sipas strukturës organizative të miratuar.

Neni 7

Përdorimi i Fondeve

1. Përdorimi i fondeve pjesë e Grantit të Mësimdhënies financuar nga Buxheti i Shtetit për institucionet publike të arsimit të lartë, bëhet si më poshtë:
 - a) Fondi për mbështetjen studentore do të përdoret me qëllim mbështetjen financiare të studentëve për përmirësimin e statusit social-ekonomik, nxitjen dhe përmirësimin e arritjeve akademike, si dhe gjithëpërfshirjen në ndjekjen e studimeve.
 - b) Fondi për mbështetjen e institucioneve të arsimit të lartë do të përdoret për të mbështetur objektivat institucional të IAL-së dhe objektivat e përbashkëta. Fondi shpërndahet me vendim të Bordit të Administrimit dhe përdoret për mbulimin e shpenzimeve që i përkasin artikujve buxhetor 600–606.
2. IAL-të raportojnë mbi përdorimin e fondeve sipas qëllimit të përcaktuar në pikën nr. 1 të këtij neni , pranë AKFAL, çdo 4 (katër) muaj.

Neni 8

Detyrimet e IAL-së

1. IAL ka këto detyrime:
 - a) të përcaktojë rregullat e brendshme të financimit, të shpërndajë dhe të përdorë të ardhurat nga buxheti i shtetit në përputhje me qëllimin për të cilin janë alokuar, si dhe në përputhje me veprimtarinë dhe nevojave të institucionit.
 - b) të përcjellë pranë AKFAL, çdo Vendim të Bordit të Administrimit mbi shpërndarjen e fondeve pjesë e Grantit të Mësimdhënies, në programin buxhetor 09450, kapitulli 08, artikulli 600–606.
 - c) të përdorë fondet e shpërndara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe AKFAL në përputhje me parimin e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit.
 - d) të miratojë tarifën vjetore të shkollimit për çdo program studimi brenda kufirit maksimal të përcaktuar dhe të përcjellin vendimin e organit kolegjal për miratimin e tyre pranë AKFAL brenda afateve ligjore.
 - e) të shpërndajë bursat financiare studentëve përfitues çdo muaj, në llogarinë bankare të studentëve, në përputhje me procedurat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
 - f) të përcjellë pranë AKFAL ngarkesën dhe masën e pagesës së personelit akademik i cili angazhohet në mësimdhënie në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e integruara, dhe programet profesionale sipas akteve nënligjore në fuqi.

- 
- g) të paraqesë në AKFAL, pas rakordimit me Degët e Thesarit, akt rakordimin lidhur me fondet e papërdorura gjatë vitit buxhetor paraardhës për: *Grupin 11, Programi 09450, Kapitulli 08, Artikujt 600, 601, 602, 604, 605, 606.*
- h) të paraqesë, raporte narrative dhe financiare për përdorimin e fondeve publike për vitin buxhetor _____, brenda datës 30 janar të vitit pasardhës, sipas formatit, mënyrës dhe afateve të përcaktuara në Aneksin 1, pjesë përbërëse e kësaj kontrate
- i) të raportojë pranë AKFAL, çdo 4 (katër) muaj mbi përdorimin e fondit institucional dhe fondit të mbështetjes studentore.
- j) të informojë AKFAL në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të lëna pas kontrollit të ushtruar në IAL, sipas gjetjeve në lidhje me përmirësimin e veprimtarisë, efektivitetin e përdorimit të fondeve, si dhe për realizimin e masave për rastet e konstatimit të moszbatimit të detyrimeve nga ana e IAL-së.
- k) të nxisë përsosmërinë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor, me qëllim rritjen e performancës dhe realizimin e objektivave strategjike.

Neni 9

Dispozita të fundit

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj.
2. Pjesë përbërëse që i bashkëlidhet kësaj marrëveshje është dhe Aneksi nr.1: *“Udhëzuesi, i cili përmban informacionet e nevojshme që duhet të përfshijnë institucionet e arsimit të lartë në raportin e tyre financiar vjetor”.*
3. Marrëveshja nënshkruhet në çdo fletë nga palët nënshkruese dhe hartohet në _____kopje të njëjta me nga (____) fletë secila.

PALËT NËNSHKRUESE

PËR

AGJENCIA KOMBËTARE E FINANCIMIT TË ARSIMIT TË LARTË

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

PËR

INSTITUCIONIN E ARSIMIT TË LARTË